

NË GJYKATËN THEMELORE NË FERIZAJ

P.nr. 250/13

29 prill 2015

Aktgjykimi i publikuar mund të mos jetë i formës së prere dhe mund të jetë objekt i ankesës në bazë të ligjit të aplikueshëm.

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, me trupin gjykues të përbërë nga gjyqtari i EULEX-it Piotr Bojarczuk, si kryetar i trupit gjykues, gjyqtarja e EULEX-it Marie Tuma dhe gjyqtari kosovar Musa Konxheli, si anëtarë të trupit gjykues, me procesmbajtësin Ragip Bugacku, në çështjen penale ndaj:

B.SH.

Nofka	-
Emri i babait
Data e lindjes
Vendi i lindjes
Gjinia	Mashkull
Adresa	Rruga (më parë me emrin Rr.) tek “ ...” në F / Rruga/..... nr.....,
Kombësia	Kosovë
Shtetësia	Shqiptar

Profesioni (.....)
Numri identifikues personal
Masat kufizuese	Në paraburgim që nga arrestimi i tij më 11 shtator 2013 dhe liruar në arrest shtëpiak më datën e sotme.

Et alii

Akuzuar në aktakuzën e prokurorit special PPS.nr. 5/12 të datës 27 dhjetor 2013 dhe paraqitur në shkrimoren e Gjykatës Themelore në Ferizaj më 27 dhjetor 2013,

Akuzuar për veprat penale:

B.SH. (dhe M.S.):

- 1. KEQPËRDORIMI I POZITËS APO AUTORITETIT ZYRTAR** në bashkë-kryerje, në shkelje të nenit 339 (1) dhe (2) në lidhje me nenin 23 të ish KPK-së, aktualisht e ndëshkueshme sipas nenit 422 në lidhje me nenin 31 të KPK-së 2013.

- 2. MARRJA E RRYSHFETIT** në bashkë-kryerje, në shkelje të nenit 343 (1) në lidhje me nenin 23 të ish KPK-së, aktualisht e ndëshkueshme sipas nenit 428 në lidhje me nenin 31 të KPK-së 2013.

3. **USHTRIMI I NDIKIMIT** në bashkë-kryerje, në shkelje të nenit 345 (1) në lidhje me nenin 23 të ish KPK-së, aktualisht e ndëshkueshme sipas nenit 431 (1) dhe nenit 31 të KPK-së 2013.

B.SH.:

9. MOSLAJMËRIMI I VEPRAVE PENALE APO KRYESVE TË TYRE, në shkelje të nenit 386, paragrafit 2, në lidhje me paragrafin 1, të KPK-së 2013.

10. MBAJTJA NË PRONËSI, KONTROLL OSE POSEDIM TË PAAUTORIZUAR TË ARMËVE, në shkelje të nenit 374 paragrafit 1, në lidhje me nenin 120, pikën 38, të Kodit Penal të Kosovës 2013

pas mbajtjes së seancave në Gjykatën Themelore të Ferizajt (mbajtur në Kaçanik) më datat 19 dhe 30 maj, 2 dhe 12 qershor, 10 dhe 11 korrik, 4 dhe 25 gusht, 8, 16, 19 dhe 30 shtator, 13 dhe 28 tetor, 13, 14 dhe 27 nëntor, 5, 8 dhe 15 dhjetor 2014 dhe 16, 26 dhe 30 janar dhe 10, 23, 24, 25, 26 shkurt 2015, 3 dhe 31 mars 2015 dhe 2 dhe 21, 23 dhe 27, 28 dhe 29 prill 2015 në praninë e prokurorit të PSRK-së Z. Drew G. Engel, të pandehurit B.Sh. dhe avokatit të tij mbrojtës A.D. (më parë R.A.) dhe gjatë së cilave seanca palët e dëmtuara ishin ose të pranishme ose të thirrura;

dhe pasi i pandehuri, B.Sh. ka treguar/ka dhënë shenja për pranim të fajësisë për veprat penale në këtë çështje dhe pas shqyrtimit të marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë, të arritur në mes të të pandehurit dhe PSRK-së më 21 prill 2015 dhe paraqitur në gjykatë gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor në Gjykatën Themelore të

Ferizajt (mbajtur në Kaçanik) gjithashtu më 27, 28 dhe 29 prill 2015, në të cilën i pandehuri, B.Sh. pranon fajësinë për veprat penale:

Pika 1 e aktakuzës: Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar, në kundërshtim me nenin 422 të KPK-së 2013, e dënueshme me burgim prej gjashtë (6) muajsh deri në pesë (5) vjet.

- Pika 2 e aktakuzës: Marrja e ryshfetit, në kundërshtim me nenin 428 të KPK-së 2013, e dënueshme me burgim prej gjashtë (6) muajsh deri në pesë (5) vjet.

- Pika 3 e aktakuzës: Ushtrimi i ndikimit, në kundërshtim me nenin 431 para 1 të KPK-së 2013, e dënueshme me gjobë apo me burgim prej deri në tetë (8) vjet.

- Pika 9 e aktakuzës: Moslajmërimi i veprave penale apo kryesve të tyre, në kundërshtim me nenin 386 para 2 të KPK-së 2013, e dënueshme me gjobë apo me burgim prej së paku tri (3) vjet.

- Pika 10 e aktakuzës: Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve, në kundërshtim me nenin 374, para. 1, të KPK-së 2013, e dënueshme me gjobë deri në shtatë mijë e pesëqind (7,500) Euro apo me burgim prej deri në pesë (5) vjet.

Trupi gjykues pas këshillimit dhe pas bindjes se përmbushen kërkesat që gjinden në nenin 233 të KPK-së, në seancë të hapur për publik dhe në praninë e palëve, gjykata, në pajtim me nenet 233 dhe 248 të KPP-së merr dhe shpall si në vijim:

AKTGJYKIM

I pandehuri, B Sh me të dhënat personale si më lart, shpallet **FAJTOR** për;

Pikën 1 të aktakuzës:

Për shkak se

Në qershor të vitit 2012, në Ferizaj, Kosovë dhe/ose në ndonjë vend tjetër në Kosovë, së bashku me të pandehurin, M.S., zi një person zyrtar, që do të thotë, toger në Policinë e Kosovës dhe shef i njësisë kundër trafikimit në Ferizaj, i pandehuri, **B.SH.**, si një person zyrtar, që do të thotë zyrtar policie, në bashkëkryerje, me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për veten e tyre, (që do të thotë 4750 Euro) kanë keqpërdorur pozitën e tyre zyrtare, domethënë kanë kërkuar para nga Xh.B. dhe A.S., dhe duke vazhduar edhe me anëtarët tjerë të familjes së B.S., duke u shkaktuar dëme financiare këtyre individëve, në këmbim të premtimit për të siguruar lirim të B.S. nga paraburgimi, apo premtimit për t'u siguruar se ai nuk do të dënohet dhe/ose premtimit për t'u siguruar se ai nuk do të vuajë dënimin e tij. Këto veprime të të pandehurve përfshinin, në mes gjërave tjera, përfaqësimet para familjes S. se të pandehurit do të kontaktonin dëshmitarët në mënyrë që ata të ndryshonin deklaratat e tyre kundër B., do t'i jepnin dhurata prokurorëve të caktuar në rastin e B. dhe të mbështesnin dëshmi të caktuara kundër B. nga shkresat e lëndës të dhëna në prokurori.

Në këtë mënyrë ka kryer veprën penale të keqpërdorimit të pozitës zyrtare, në kundërshtim me nenin 422 të KPK-së 2013, e dënueshme me burgim prej gjashtë (6) muajsh deri në pesë (5) vjet.

Pikën 2 të aktakuzës:

Për shkak se

Në qershor të vitit 2012, në Ferizaj, Kosovë dhe/ose në ndonjë vend tjetër në Kosovë, së bashku me të pandehurin, M.S., zi një person zyrtar, që do të thotë, toger në Policinë e Kosovës dhe shef i njësisë kundër trafikimit në Ferizaj, i pandehuri, **B.SH.**, si një person zyrtar, që do të thotë zyrtar policie, në bashkëkryerje kanë kërkuar dhe pranuar dhuratë ose ndonjë përfitim tjetër për veten e tyre, (që do të thotë, pagesa në para që arrinte shumën e përgjithshme 4750 Euro) për të kryer në kuadër të fushëveprimit të autoritetit të tyre një veprim zyrtar apo një veprim tjetër, të cilin ai ose ajo nuk duhet ta kryejë apo të dështojë që të kryejë një veprim zyrtar apo një veprim tjetër të cilin ata është dashur apo kanë mundur ta kenë kryer, kështu që ose për të siguruar lirimin e B.S. nga paraburgimi, apo për t'u siguruar se ai nuk do të dënohej dhe/ose për t'u siguruar se ai nuk do të vuante dënimin e tij. Këto veprime të të pandehurve përfshinin, në mes gjërave tjera, përfaqësimet para familjes S. se të pandehurit do të kontaktonin dëshmitarët në mënyrë që ata të ndryshonin deklaratat e tyre kundër B., do t'i jepnin dhurata prokurorëve të caktuar në rastin e B. dhe të mbështesnin dëshmi të caktuara kundër B. nga shkresat e lëndës të dhëna në prokurori.

Në këtë mënyrë ka kryer veprën penale të marrjes së ryshfetit, në kundërshtim me nenin 428 të KPK-së 2013, e dënueshme me burgim prej gjashtë (6) muajsh deri në pesë (5) vjet.

Pika 3 e aktakuzës:

Për shkak se

Në qershor të vitit 2012, në Ferizaj, Kosovë dhe/ose në ndonjë vend tjetër në Kosovë, të pandehurit **M.S.** dhe **B.SH.**, në bashkë-kryerje, kanë kërkuar dhe kanë marrë një ofertë (që do të thotë, pagesa në para që arrinte shumën e përgjithshme 4750 Euro) të ndonjë përfitimi për veten e tyre në shqyrtimin e ushtrimit të një ndikimi të papërshtatshëm nga kryesi i veprës penale mbi vendimmarrjen e personit zyrtar, kështu që ose për të siguruar lirimin e B.S. nga paraburgimi, apo për t'u siguruar se ai nuk do të dënohej dhe/ose për t'u siguruar se ai nuk do të vuante dënimin e tij, nëse ndikimi është ushtruar apo jo ose nëse ndikimi i supozuar shpie tek rezultati i synuar apo jo.

Në këtë mënyrë ka kryer veprën penale të ushtrimit të ndikimit, në kundërshtim me nenin 431 para, 1 të KPK-së 2013, e dënueshme me gjobë apo me burgim deri në tetë (8) vjet.

Pika 9 e aktakuzës:

Sepse në mars të vitit 2013, në Ferizaj, Kosovë dhe/ose në ndonjë vend tjetër në Kosovë, i pandehuri **B.SH.**, zyrtar policie, ishte informuar nga Xh.B. dhe K.S. se disa persona (tani të njohur si B.V., S.M. dhe A.M.) e kanë shtyrë Xh.B. dhe K.S., dhe duke vazhduar edhe me anëtarët tjerë të familjes së B.S., që të paguajë 40,000 Euro në mënyrë që të siguroheshin se B.S. nuk do të dënohej (në ankesë) dhe/ose për t'u siguruar se ai nuk do të vuante dënimin e tij. Prandaj, B.Sh. ishte informuar se ishin kryer veprat penale të marrjes së ryshfetit (neni 428 KPK) dhe/ose ushtrimit të ndikimit (neni 431 KPK), të cilat ai më pas nuk i kishte raportuar.

Në këtë mënyrë ka kryer veprën penale të moslajmërimit të veprave penale apo kryesve të tyre, në kundërshtim me nenin 386 para.2 të KPK-së 2013, e dënueshme me gjobë apo me burgim prej së paku tri (3) vjet.

Pika 10 e aktakuzës:

Sepse më 11 shtator 2013, në Ferizaj, Kosovë, **B.SH.** ka mbajtur në pronësi, në posedim ose në kontroll një pushkë gjuetie gjysmë-automatike dhe gjashtëdhjetë e një (61) fishekë të një pushke gjysmë automatike, në kundërshtim me ligjin.

Në këtë mënyrë ka kryer veprën penale të mbajtjes në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve, në kundërshtim me nenin 374, para 1, të KPK-së 2013, e dënueshme me gjobë prej shtatë mijë e pesëqind (7,500) Euro, apo me burgim prej deri në pesë (5) vjet.

Për arsyet e përmendura më lart trupi gjykues shqipton si në vijim:

ARSYETIM

A. KOMPETENCA E TRUPIT GJYKUES

Sipas nenit 11 (1) të Ligjit për Gjykatat, ligji nr. 03/L-199, gjykatat themelore janë kompetente për të gjykuar në shkallë të parë të gjitha çështjet, përpos nëse me ligj parashihet ndryshe. Neni 8 i Ligjit për Gjykatat konstaton se Gjykata Themelore në Ferizaj është themeluar për territorin e *inter alia* Gjykatës Komunale të Ferizajt. I pandehuri, B.Sh. ishte i bashkë-akuzuar në të njëjtën aktakuzë me pesë të pandehur të akuzuar për veprat penale që vijnë në kuadër të nenit 15 (1.19) të të njëjtit ligj.

Aktakuza në këtë rast është ngritur më 27 dhjetor 2013.

B. HISTORIKU PROCEDURAL

Më 23 mars 2013, prokurori ka nxjerrë një vendim mbi fillimin e hetimeve, që është zgjeruar më 28 mars 2013 pas lëshimit nga prokurori të një vendimi mbi zgjerimin e hetimeve.

Më 11 shtator 2013, është arrestuar i pandehuri B.Sh. dhe më 12 shtator 2013 gjyqtari i procedurës paraprake urdhëroi paraburgimin ndaj të gjithë të pandehurve në këtë rast, përfshirë të pandehurin B.Sh., për një periudhë kohore prej një (1) muaji. Pas skadimit të kësaj periudhe, prokurori ka kërkuar që ajo të vazhdohej. Gjyqtari i procedurës paraprake e miratoi këtë kërkesë. Periudha e paraburgimit është vazhduar në pajtim me statutin kohë pas kohe. I pandehuri, B.Sh. paraqiti ankesa në Gjykatën e Apelit dhe në Gjykatën Supreme të Kosovës, por këto janë refuzuar pandryshueshëm. Më 27 dhjetor 2013, prokurori ngriti aktakuzën PPS Nr. 05/2012, ku zyrtarisht ka akuzuar të pandehurit B.Sh., M.S., B.V., S.M. dhe R.A. Të gjitha ankesat për të hedhur apo refuzuar aktakuzën dhe/ose provat janë hedhur poshtë në shkallën e parë dhe në apel.

Shqyrtimi kryesor në këtë rast filloi më 19 maj 2014 në Gjykatën Themelore të Ferizajt (mbajtur në Kaçanik). Seancat janë mbajtur gjithashtu më 30 maj, 2 qershor, 12 qershor, 10 dhe 11 korrik, 4, 25 dhe 26 gusht, 8, 16, 19 dhe 30 shtator, 13 dhe 28 tetor dhe 13, 14 dhe 27 nëntor 2014. Janë mbajtur gjithashtu seanca më 5, 8 dhe 15 dhjetor 2014, 16, 26 dhe 30 janar dhe 10, 23, 24 dhe 25 shkurt 2015, 31 mars 2015 dhe 2, 21, 23 dhe 27, 28 dhe 29 prill 2015.

C. PROVAT E PRANUESHME

I pandehuri B.Sh. ka pranuar fajësinë në bazë të provave që gjenden në aktakuzë. Ai është këshilluar plotësisht në kohën përkatëse nga avokati i tij mbrojtës, A.D. dhe para tij, R.A. Trupi gjykues ka shqyrtuar marrëveshjen për pranimin e fajësisë në këshillimin e tij më datat 27, 28 dhe 29 prill 2015.

Gjatë seancës së parë të shqyrtimit fillestar në këtë rast, më 10 janar 2014, i pandehuri B.Sh. deklaroi se ai pranonte armën dhe municionin nga pika 10 e aktakuzës (që do të thotë, veprën penale të përdorimit të armës apo mjetit të rrezikshëm, në kundërshtim me nenin 375 paragrafët 1 dhe 2 të KPK-së) të cilat ishin zbuluar gjatë një kontrolli të shtëpisë së tij edhe pse ai u ndal menjëherë pas pranimit të fajësisë për këtë vepër penale.

Më 27 janar 2014 avokati mbrojtës i atëhershëm i të pandehurit B.Sh., avokati R.A., paraqiti një kundërshtim ndaj provave, në pajtim me nenin 249 të KPP-së. Ai u kundërshtua me urdhërin e kryetarit të trupit gjykues të datës 6 mars 2014. Avokati mbrojtës nuk paraqiti një ankesë e as nuk paraqiti një kërkesë për hudhje të aktakuzës.

Më 27 janar 2014 avokati mbrojtës i atëhershëm i të pandehurit B.Sh., avokati R.A., paraqiti gjithashtu një kërkesë për hedhje të aktakuzës, në pajtim me nenin 250 të KPP-së. Kjo është refuzuar gjithashtu me urdhërin e kryetarit të trupit gjykues të datës 6 mars 2014. Avokati mbrojtës nuk ka paraqitur ndonjë ankesë.

Marrëveshja për pranimin e fajësisë e arritur në mes të PSRK-së dhe të pandehurit B.Sh. ishte bazuar në provat e paraqitura në aktakuzë, të cilat i janë zbuluar të

pandehurit para shqyrtimit fillestar dhe provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor.

D. KONSTATIMET FAKTIKE

Në bazë të marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë të arritur në mes të pandehurit B.Sh. dhe PSRK-së, trupi gjykues bënë të gjeturat e fakteve në vijim:

Pika 1 e aktakuzës:

Për shkak se

Në qershor të vitit 2012, në Ferizaj, Kosovë dhe/ose në ndonjë vend tjetër në Kosovë, së bashku me të pandehurin, M.S., zi një person zyrtar, që do të thotë, toger në Policinë e Kosovës dhe shef i njësisë kundër trafikimit në Ferizaj, i pandehuri, **B.SH.**, si një person zyrtar, që do të thotë zyrtar policie, në bashkëkryerje dhe me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për veten e tyre, (që do të thotë 4750 Euro) kanë keqpërdorur pozitën e tyre zyrtare, domethënë kanë kërkuar para nga Xh.B. dhe A.S., dhe duke vazhduar edhe me anëtarët tjerë të familjes së B.S., duke u shkaktuar dëme financiare këtyre individëve, në këmbim të premtimit për të siguruar lirimin e B.S. nga paraburgimi, apo premtimit për t'u siguruar se ai nuk do të dënohet dhe/ose premtimit për t'u siguruar se ai nuk do të vuajë dënimin e tij. Këto veprime të të pandehurve përfshinin, në mes gjërave tjera, përfaqësimet para familjes S. se të pandehurit do të kontaktonin dëshmitarët në mënyrë që ata të ndryshonin deklaratat e tyre kundër B., do t'i jepnin dhurata prokurorëve të caktuar në rastin e B. dhe të mbështesnin dëshmi të caktuara kundër B. nga shkresat e lëndës të dhëna në prokurori.

Në këtë mënyrë ka kryer veprën penale të keqpërdorimit të pozitës zyrtare, në kundërshtim me nenin 422 të KPK-së 2013, e dënueshme me burgim prej gjashtë (6) muajsh deri në pesë (5) vjet.

Pika 2 e aktakuzës:

Për shkak se

Në qershor të vitit 2012, në Ferizaj, Kosovë dhe/ose në ndonjë vend tjetër në Kosovë, së bashku me të pandehurin, M.S., zi një person zyrtar, që do të thotë, toger në Policinë e Kosovës dhe shef i njësisë kundër trafikimit në Ferizaj, i pandehuri, **B.SH.**, si një person zyrtar, që do të thotë zyrtar policie, në bashkëkryerje kanë kërkuar dhe pranuar dhuratë ose ndonjë përfitim tjetër për veten e tyre, (që do të thotë, pagesa në para që arrinte shumën e përgjithshme 4750 Euro) për të kryer në kuadër të fushëveprimit të autoritetit të tyre një veprim zyrtar apo një veprim tjetër, të cilin ai ose ajo nuk duhet ta kryejë apo të dështojë që të kryejë një veprim zyrtar apo një veprim tjetër të cilin ata është dashur apo kanë mundur ta kenë kryer, kështu që ose për të siguruar lirim të B.S. nga paraburgimi, apo për t'u siguruar se ai nuk do të dënohej dhe/ose për t'u siguruar se ai nuk do të vuante dënimin e tij. Këto veprime të të pandehurve përfshinin, në mes gjërave tjera, përfaqësimet para familjes S. se të pandehurit do të kontaktonin dëshmitarët në mënyrë që ata të ndryshonin deklaratat e tyre kundër B., do t'i jepnin dhurata prokurorëve të caktuar në rastin e B. dhe të mbështesnin dëshmi të caktuara kundër B. nga shkresat e lëndës të dhëna në prokurori.

Në këtë mënyrë ka kryer veprën penale të marrjes së ryshfetit, në kundërshtim me nenin 428 të KPK-së 2013, e dënueshme me burgim prej gjashtë (6) muajsh deri në pesë (5) vjet.

Pika 3 e aktakuzës:

Për shkak se

Në qershor të vitit 2012, në Ferizaj, Kosovë dhe/ose në ndonjë vend tjetër në Kosovë, të pandehurit **M.S.** dhe **B.SH.**, në bashkë-kryerje, kanë kërkuar dhe kanë marrë një ofertë (që do të thotë, pagesa në para që arrinte shumën e përgjithshme 4750 Euro) të ndonjë përfitimi për veten e tyre në shqyrtimin e ushtrimit të një ndikimi të papërshtatshëm nga kryesi i veprës penale mbi vendimmarrjen e personit zyrtar, kështu që ose për të siguruar lirimin e B.S. nga paraburgimi, apo për t'u siguruar se ai nuk do të dënohej dhe/ose për t'u siguruar se ai nuk do të vuante dënimin e tij, nëse ndikimi është ushtruar apo jo ose nëse ndikimi i supozuar shpie tek rezultati i synuar apo jo.

Në këtë mënyrë ka kryer veprën penale të ushtrimit të ndikimit, në kundërshtim me nenin 431 para, 1 të KPK-së 2013, e dënueshme me gjobë apo me burgim deri në tetë (8) vjet.

Pika 9 e aktakuzës:

Sepse në mars të vitit 2013, në Ferizaj, Kosovë dhe/ose në ndonjë vend tjetër në Kosovë, i pandehuri **B.SH.**, zyrtar policie, ishte informuar nga Xh.B. dhe K.S. se disa persona (tani të njohur si B.V., S.M. dhe A.M.) e kanë shtyrë Xh.B. dhe K.S., dhe duke vazhduar edhe me anëtarët tjerë të familjes së B.S., që të paguajë 40,000 Euro në mënyrë që të siguroheshin se B.S. nuk do të dënohej (në ankesë) dhe/ose për t'u siguruar se ai nuk do të vuante dënimin e tij. Prandaj, B.Sh. ishte informuar se ishin kryer veprat penale të marrjes së ryshfetit (neni 428 KPK) dhe/ose ushtrimit të ndikimit (neni 431 KPK), të cilat ai më pas nuk i kishte raportuar.

Në këtë mënyrë ka kryer veprën penale të moslajmërimit të veprave penale apo kryesve të tyre, në kundërshtim me nenin 386 para.2 të KPK-së 2013, e dënueshme me gjobë apo me burgim prej së paku tri (3) vjet.

Pika 10 i aktakuzës:

Sepse më 11 shtator 2013, në Ferizaj, Kosovë, **B.SH.**, ka mbajtur në pronësi, në posedim ose në kontroll një pushkë gjuetie gjysmë-automatike dhe gjashtëdhjetë e një (61) fishekë të një pushke gjysmë automatike, në kundërshtim me ligjin.

Në këtë mënyrë ka kryer veprën penale të mbajtjes në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve, në kundërshtim me nenin 374, para 1, të KPK-së 2013, e dënueshme me gjobë prej shtatë mijë e pesëqind (7,500) Euro, apo me burgim prej deri në pesë (5) vjet.

Marrëveshja për pranimin e fajësisë në mes të pandehurit B.Sh. dhe PSRK-së, e datës 21 prill 2015 ka përmbajtur gjithashtu një Shtojcë në të cilën i pandehuri, B.Sh. ka konfirmuar fakte të caktuara të cilat ia paraqiti atij prokurori. Kjo shtesë i është bashkëngjitur këtij aktgjykimi.

E. ANALIZA E PROVAVE

Trupi gjykues ka analizuar marrëveshjen për pranimin e fajësisë dhe Shtojcën e nxjerrë në mes të PSRK-së dhe të pandehurit B.Sh. dhe njëzëri janë pajtuar për veprat penale për të cilat i pandehuri ka pranuar fajësinë, të cilat janë mbështetur nga pretendimet faktike që gjenden në aktakuzë. Në veçanti, deklaratat e familjes

S. dhe incizimet e telefonave celular të bisedave në mes tyre dhe të pandehurit mbështesnin fuqishëm të pandehurin, fajësinë e B.Sh. në lidhje me të gjitha veprat penale me të cilat ai akuzohet në aktakuzë.

G. CAKTIMI I DËNIMIT

Trupi gjykues është i bindur njëzëri se dënimet që gjenden në marrëveshjen e pranimit të fajësisë të negociuara në mes të pandehurit B.Sh. dhe PSRK-së, janë brenda intervalit ligjor, janë proporcionale me veprat penale të kryera arrijnë një ekuilibër të duhur në mes të të drejtës së gjykatës për të dënuar të pandehurin dhe detyrës së saj për t'i ofruar atij një mundësi për rehabilitim.

H. KONFISKIMI

Gjykata urdhëron konfiskimi e armës dhe municionit të sekuestruara nga shtëpia e të pandehurit.

I. SHPENZIMET E PROCEDURËS

Bazuar në marrëveshjen për pranimin e fajësisë të negociuar në zyrat e PSRK-së më 21 prill 2015, në mes të prokurorit të PSRK-së, Z. Drew Engel (autorizuar nga Krye-Prokurori i PSRK-së), të pandehurit B.Sh. dhe Z. A.D., avokatit mbrojtës të të pandehurit, shpenzimet e procedurës do të kompensohen nga i pandehuri. Shpenzimet e procedurës penale të llogaritura në shumë prej 100 (njëqind) Eurosh së bashku me shumën paushalle, të llogaritur në shumë prej 50 (pesëdhjetë) Eurosh.

DËNIMET

Bazuar në marrëveshjen për pranimin e fajësisë të negociuar në zyrat e PSRK-së më 21 prill 2015 në mes të prokurorit të PSRK-së, Z. Drew Engel (autorizuar nga Krye-Prokurori i PSRK-së), të pandehurit B.Sh. dhe A.D., avokatit mbrojtës të të pandehurit dhe në pajtim me nenin 233 të KPP-së dënohet si në vijim:

Pika 1 e aktakuzës: Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar, në kundërshtim me nenin 422 të KPK-së 2013, e dënueshme me burgim prej gjashtë (6) muajsh deri në pesë (5) vjet.

Katër (4) vjet e gjashtë (6) muaj burgim.

Pika 2 e aktakuzës: Marrja e ryshfetit, në kundërshtim me nenin 428 të KPK-së 2013, e dënueshme me burgim prej gjashtë (6) muajsh deri në pesë (5) vjet.

Katër (4) vjet e gjashtë (6) muaj burgim.

Pika 3 e aktakuzës: Ushtrimi i ndikimit, në kundërshtim me nenin 431 para 1 të KPK-së 2013, e dënueshme me gjobë apo me burgim prej deri në tetë (8) vjet.

Pesë (5) vjet burgim.

Pika 9 e aktakuzës: Moslajmërimi i veprave penale apo kryesve të tyre, në kundërshtim me nenin 386 para 2 të KPK-së 2013, e dënueshme me gjobë apo me burgim prej së paku tri (3) vjet.

Dy (2) vjet e nëntë (9) muaj burgim.

Pika 10 e aktakuzës: Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve, në kundërshtim me nenin 374, para. 1, të KPK-së 2013, e dënueshme me gjobë deri në shtatë mijë e pesëqind (7,500) Euro apo me burgim prej deri në pesë (5) vjet.

Katër (4) vjet e gjashtë (6) muaj burgim

Në pajtim me nenin 80.1 të KPRK-së gjykata ka shqiptuar dënim unik prej pesë (5) viteve. Vuajtja e të gjitha dënimeve me burgim do të bëhet njëkohësisht.

Megjithatë, në pajtim me nenin 83.1 të KPK-së, të pandehurit i llogaritet koha që ai tanimë ka vuajtur në paraburgim, si në vijim:

Një vit (1), shtatë (7) muaj dhe tetëmbëdhjetë (18) ditë në paraburgim, nga 11 shtator 2013 deri më 29 prill 2015;

Periodha kohore tanimë e kaluar në paraburgim dhe në arrest shtëpiak arrin në një (1) vit, shtatë (7) muaj dhe tetëmbëdhjetë (18) ditë. Dënimi unik i paraburgimit të shqiptuar është pesë vjet (d.m.th. gjashtëdhjetë (60) muaj). Siç tanimë kemi rënë dakord me të pandehurin, B.Sh. dhe PSRK-në i pandehuri do të lirohet në arrest shtëpiak nga 29 prilli 2015 deri më 11 shtator 2015, kur ai do të lirohet me kusht që ai të sillet mirë për një periudhë kohore prej tri (3) viteve.

I pandehuri B.Sh. do të bëjë **200 orë të punës në dobi të përgjithshme** në qendër komuniteti, bamirësi, strehim të kafshëve, apo ndonjë organizate tjetër jo-profitabile caktuar nga gjykata, që do të jetë gjithashtu përgjegjëse për të raportuar për zbatimin e këtij urdhëri. I pandehuri do të bëjë dyqind (200) orë të punës në dobi të përgjithshme sipas zgjedhjes së gjykatës apo autoritetit të saj të caktuar për shqyrtim *jo më vonë në dhjetor 2015 duke filluar nga 12 shtatori 2015*. Do të ketë një shqyrtim të realizimit të orëve të punës në dobi të përgjithshme, jo më vonë se më 28 shkurt 2016, për të përcaktuar nëse orët janë përfunduar nga i pandehuri. Nëse gjykata nuk është në gjendje të gjejë një qendër komuniteti, bamirësi, strehim të kafshëve apo ndonjë organizate tjetër jo-profitabile, atëherë i pandehuri do të bëjë 200 orë punë vullnetare në një shtëpi të pleqve (të caktuar nga gjykata) në rajonin e Ferizajt dhe të njëjtat kërkesa do të zbatohen sa i përket datës së përmbushjes dhe verifikimit.

Të pandehurit B.Sh. i ndalohet gjithashtu që të punësohet si zyrtar policie në ndonjë cilësi policie dhe/ose të sigurisë dhe/ose në çfarëdo cilësie që kërkon ose lejon bartjen e armës së zjarrit apo armë të tjera të ndaluara sipas nenit KPK për një periudhë të përgjithshme prej njëzet (20) viteve.

I pandehuri, R.A. nuk duhet të ketë asnjë kontakt (të drejtpërdrejtë apo të tërthortë) me viktimën A.Xh., përveç nëse ajo deklaron në formë të shkruar se ajo deklaron gatishmërinë e saj për të patur një kontakt të tillë dhe gjykata e aprovon atë;

Të pandehurit R.A. i ndalohet që të ketë çfarëdo dhe çdo kontakt me dëshmitarët në këtë rast dhe/ose pjesëtarët e afërt të familjes, përveç nëse personat e tillë e deklarojnë me shkrim gatishmërinë e tyre për të patur kontakte të tilla dhe përveç nëse ato kontakte miratohen nga gjykata. Në mënyrë të ngjashme, të pandehurit B.Sh. i ndalohet që të ketë çfarëdo kontakti me viktimat dhe/ose anëtarët e

familjeve të tyre, përveç nëse personi i tillë deklaron në formë të shkruar gatishmërinë e tyre për të patur një kontakt të tillë dhe përveç nëse kontaktet e tilla miratohen nga gjykata. Të pandehurit B.Sh. i ndalohet gjithashtu që të ketë çfarëdo dhe çdo kontakt me të gjithë të pandehuri dhe/ose pjesëtarët e familjes së tyre, përveç nëse personat e tillë e deklarojnë me shkrim gatishmërinë e tyre për të patur kontakte të tilla dhe përveç nëse ato kontakte miratohen nga gjykata

Gjykata urdhëron konfiskimin e përkohshëm të armës dhe municionit të përdorur nga i pandehuri gjatë kryerjes së veprës penale në pikën 10 në këtë çështje.

Sipas pikës (e) në faqe gjashtë (6) të marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë, ky aktgjykim është i formës së prerë dhe ndaj tij nuk mund të paraqitet ankesë.

J. Kompensimi i familjes S.

Në lidhje me këtë çështje, merr parasysh pikën 13 në faqe 4 të marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë ku i pandehuri B.Sh. dhe PSRK-ja kanë rënë dakord që i pandehuri B.Sh. do të paguajë tërë paratë e kërkuara nga familja S., nga i pandehuri dhe/ose tërë paratë e marrë nga i pandehuri si përfitim material të veprave penale në kryera në këtë rast, për të cilin i pandehuri pranon fajësinë.

Trupi gjykues merr parasysh se pala e dëmtuar, B.S. pretendon të ketë pësuar dëme të konsiderueshme materiale dhe jo-materiale për veten e tij, familjen e tij dhe kompaninë e tij “L” si rezultat i veprimeve kriminale të të pandehurit B.Sh. Në fakt, pala e dëmtuar, B.S. ka paraqitur një dokument në fillim të shqyrtimit gjyqësor ku vlerëson këto humbje përafërsisht 1.4 milion €. Megjithatë, kjo shumë nuk është specifikuar mjaftueshëm dhe/ose dëshmuar/vërtetuar për t’i lejuar trupit gjykues që

të nxjerrë ndonjë urdhër në lidhje me këtë. Prandaj, ky pretendim do të jetë objekt i një kërkesë të veçantë civile, në pajtim me nenin 463 të KPP-së.

Përveç kësaj, trupi gjykues është në dijeni se familja S. u ka paguar €4,750 të pandehurve, B.Sh. dhe gjoja të pandehurit M.S., për të siguruar lirimin nga paraburgimi të B.S. Në këtë pikë trupi gjykues nuk mund të lëshojë ndonjë urdhër sa i përket përgjegjësisë së të pandehurit B.Sh., për kthimin e kësaj shume, derisa të përfundohet rasti ndaj të pandehurit M.S. dhe derisa të merret aktgjykimi. I pandehuri M.S. nuk ka pranuar fajësinë dhe gjykimi është duke u zhvilluar. Nëse i pandehuri M.S. lirohet, e tërë përgjegjësia për kthimin e shumës prej €4,750 do i mbetet të pandehurit B.Sh. Megjithatë, nëse i pandehuri M.S. dënohet për të gjitha apo ndonjërin nga veprat penale në lidhje me marrjen e paligjshme të shumës prej €4,750 atëherë ai dhe i pandehuri B.Sh. do të jenë përgjegjës në mënyrë solidare për kthimin e kësaj shume familjes S.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

P. nr. 250/13

Më datën 29 prill 2015

Piotr Bojarczuk

Kryetar i trupit gjykues

Marie Tuma

Anëtare e trupit gjykues

Musa Konxheli

Anëtar i trupit gjykues

Sara Xhemali

Procesmbajtëse